



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion

Mbledhja nr. 43

Prishtinë, më 11 prill 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion

Në mbledhje morën pjesë: Arben Gashi - kryetar i Komisionit, Behar Selimi – nënkryetar, Arsim Bajrami, Halit Krasniqi, Ardian Gjini, Amir Ahmeti, Albulena Haxhiu, Armend Zemaj, Haki Demolli, Mufera Šinik dhe Jasmina Zhivković.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Lumnije Murati – ZPRK, Isuf Zejna – KDI, Lejla Selimi – OSBE, Petrit Hysaj – OSBE, Vlora Marmullakaj – EULEX, Haxhi Gashi – USAID, Lulzim Rafuna – MF, Arben Shanolli – IPSK, Blerim Kelmendi – AKK, Afrim Atashi – AKK dhe Eroll Gashi, Fitore Sadiku dhe Fjolla Krasniqi – praktikantë.

Nga stafi i Komisionit për Legjislacion: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Arben Gashi, kryetar i Komisionit.

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 27.02.2012;
3. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2011;
4. Shqyrtimi i propozimamendamenteve të grupit të punës në Projektligjin për marrëdhëniet e detyrimeve;
5. Shqyrtimi i propozimamendamentit në Projektkodin penal të Kosovës;
6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-062 për fshatin Hoçë e Madhe;
7. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për mbeturina nr. L-60;
8. Njoftimi i Komisionit për skadimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës;
9. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari propozoi që pika 6 të hiqet nga rendi ditës.

Behar Selimi: Propozoi që në pikën *Të ndryshme* të shqyrtohet edhe Projektligji për Administratën Tatimore dhe procedurat.

Komisioni me 6 vota “për”, 2 “kundër”, 1 “abstenim” miratoi rendin e ditës me ndryshimet e propozuara.

Armend Zemaj nuk mori pjese ne votim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 27.02.2012

Kryetari konstatoi se Komisioni e miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 30. 01. 2012, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2011

Kryetari, ftoi drejtorin e Agjencisë ta paraqesë arsyetimin e raportit.

Hasan Preteni – I prezantoi aktivitetet e AKK-së dhe theksoi se vitin e kaluar janë hetuar 160 raste. Prej tyre më së shumti informacione për veprimet e mundshme korruptive janë pranuar nga kategoria e institucioneve të tjera si Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës, PTK-ja, KEK-u, RTK-ja, AKP-ja dhe ish-ndërmarrjet shoqërore, ndërmarrjet e tjera publike, si dhe institucionet e pavarura. Kundër tyre janë pranuar 60 raste. Sa i përket Qeverisë së Kosovës, ka pasur 30 raste. Në kategorinë e pushtetit lokal kanë qenë 56 sosh, ndërsa për prokurorinë 3 raste dhe për gjykatat 11 raste të dyshuara për veprime korruptive. Para anëtarëve të Komisionit tha se kur është konstatuar se ka të dhëna të mjaftueshme ose dyshim të arsyeshëm se rasti mund të përbëjë vepër penale, është përcjellë në prokuroritë publike kompetente të Kosovës dhe të EULEX-it, si dhe në organet policore kompetente dhe në Policinë e EULEX-it për procedim të mëtejshëm. Nga numri i përgjithshëm i rasteve të proceduara në prokuroritë publike dhe në organet policore kompetente, numrin më të madh të tyre e përbëjnë veprimet korruptive: shpërdorimi i pozitës zyrtare. Sipas tij karakteristikat e veprave më të shpeshta janë qëllimi i përfitimit në mënyrë të paligjshme. Problemet më të shumta kanë të bëjnë me fushën e prokurimit, duke përmendur kështu falsifikimin e dokumenteve të ndryshme. Kemi identifikuar 6 kontrata për të cilat janë dhënë mjete, por asnjëra nga to nuk ka hyrë në funksion. Më tej shtoi se 90 për qind e rasteve të hetimeve nga EULEX-i, zanafillën e kanë nga AKK-ja. Në vazhdim tha se 96.16 për qind të zyrtarëve e kanë deklaruar pasurinë. Ndërkaq, 88 zyrtarë nuk e kanë respektuar këtë obligim ligjor. Në fund tha se në AKK nuk ka pasur shkelje të ligjit, nuk ka pasur shkelje e as falsifikim të dokumenteve, e as keqpërdorim të buxhetit.

Kryetari - Pyeti se çfarë ka bërë Agjencia apo cilat kanë qenë objektivat kryesore që të parandalohet korrupsioni dhe të ndryshohet perceptimi për korrupsionin?

Arsim Bajrami - Kërkoi që Agjencia të krijojë një sektor të veçantë, i cili do të merrej me origjinën e kompanive të cilët janë fituesit më të mëdhenj të tenderëve dhe të bëhet një studim për këto kompani.

Armend Zemaj - Pyeti sa ka pasur efekt deklarimi publik i pasurisë së zyrtareve të lartë? Kërkesën për denoncim, që do ta bëjë edhe me shkrim, do të dërgoj në agjenci për keqpërdorimin e parasë publike që ka ndodhur në Komunën e Deçanit për kompaninë fituese të tenderit gjatë periudhës së dimrit, kur ishte shpallur edhe gjendje e jashtëzakonshme. Ai kërkoi që puna e Agjencisë të koncentrohet jo vetëm në nivel qendror, por më shumë në atë lokal, sepse sipas tij disa komuna e kanë privatizuar në total buxhetin vetjak.

Albulena Haxhiu - Shprehu shqetësimin se ekziston një dallim i madhe midis rasteve të proceduara dhe atyre që janë zgjidhur. Në vazhdim pyeti pse në rastin e deputetit Shaip Muja nuk e keni ndërruar datën e deklarimit të biznesit të tij si deklarim shtesë, por e keni regjistruar si deklarim të rregullt, ndërsa për deputetët e tjerë keni paraqitur data të tjera të regjistrimit?

Amir Ahmeti - Pyeti a e arsyeton Agjencia veten për të ekzistuar, pasi që u përmend se shumë shtete të rajonit nuk kanë agjenci antikorrupsion. Ku ka stagnuar luftimi i korrupsionit të hallkat e tjera, nëse ju si hallkë e parë e luftimit e keni kryer punën tuaj?

Haki Demolli - Adresoi një mori pyetjesh për drejtorin e AKK-së, se a ka ndonjë pengesë në punën e Agjencisë, që në raport, sa i përket nivelit qendror, asnjë ministër apo ish ministër nuk është i përmendur që ka qenë i përfshirë në afëra korruptive? Sa është marre Agjencia me hetimin e mëtutjeshëm dhe sa është i saktë deklarimi i pasurisë? Pse për gjyqësorin kemi vetëm 2 raste në raport, kur e dimë se gjyqësori vazhdon të jetë më i korruptuari dhe njëherësh paraqet hallkën më të rëndësishme të luftimit të korrupsionit?

Halit Krasniqi - Inkurajoi Agjencinë për vazhdimin e punës së tij dhe ofroi përkrahjen e tij si anëtar i Komisionit për Legjislacion.

Ardian Gjini - Kërkoi nga Agjencia të bëjë një hulumtim kualitativ se çfarë instrumentesh ligjore apo mekanizmash i duhen Agjencisë për të luftuar korrupsionin, që në si shoqëri, por më shumë si Kuvend ta ndihmojmë në punën e tij.

Pyetjeve të anëtarëve të Komisionit iu përgjigj drejtori Agjencisë, z. Hasan Preteni.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion me tetë vota “për”, një “kundër” dhe një “abstenim”, vendosi që Kuvendit t’ia paraqesë këtë

Rekomandim

Të shqyrtohet dhe të miratohet raportit vjetor i Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2011

3. Shqyrtimi i propozimamendamenteve të grupit të punës në Projektligjin për marrëdhëniet e detyrimeve

Kryetari - Në cilësi të kryesuesit të grupit të punës paraqiti për shqyrtim dhe miratim propozimamendamentet e propozuara dhe kërkoi nga anëtarët që nëse kanë vërejtje për amendamentet t'i paraqesin.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

I. Miratohet Raporti me amendamente i Komisionit për Legjislacion.

II. I rekomandohet Kuvendit të Kosovës miratimi i Projektligjit për marrëdhëniet e detyrimeve, me amendamentet e propozuara.

III. Amendamentet e Miratuara janë paraqitur si aneks i këtij Procesverbali.

5. Shqyrtimi i propozimamendamentit në Projektkodin penal të Kosovës

Kryetari - E njoftoi Komisionin që është kërkuar të futet edhe një amendament në Projektkodin Penal të Kosovës si vijon: Neni 442, në rreshtin e fundit hiqen fjalët “**1 Korrik 2012**“ dhe zëvendësohet me fjalët: “**1 janar 2013.**”

Propozimi mori mbështetjen e anëtarëve të Komisionit.

6. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për mbeturina nr. L-60

Kryetari - Paraqiti për shqyrtim raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin për mbeturina dhe kërkoi nga anëtarët që të deklarohen, nëse kanë vërejtje.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion njëzëri nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji për mbeturina nr. L-60, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisionit FunkSIONAL e kanë bazën juridike në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
3. Projektligji me amendamentet e propozuara nga Komisioni FunkSIONAL mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhjen plenare të Kuvendit.

7. Njoftimi i Komisionit për skadimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës

Kryetari - E njoftoi Komisionin se anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës iu skadon mandati gjatë këtij muaji. Kjo është vetëm sa për njoftimin tuaj.

8. Te ndryshme

a. Shqyrtimi i raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 04/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe procedurat nr. 03/L-222

Komisioni e rishqyrtoi Raportin me amendamente të propozuara nga Komisioni FunkSIONAL dhe vlerësoi se ndryshimet e bëra e kanë bazë juridike. Komisioni u pajtua me ndryshimet e propozuara, edhe pse kryetari i Komisionit kishte vërejtje lidhur me ndryshimet që kanë të bëjnë me procedurën e ankesës.

Në momentin e votimit të pranishëm ishin 9 deputetë.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Legjislacion me 7 vota “për”, 1 “kundër” dhe 1 “abstenim” nxori këtë

Përfundim

1. Projektligji nr. 04/L-102 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe procedurat nr. 03/L-222, e ka bazën juridike në nenin 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Amendamentet e propozuara nga Komisionit FunkSIONAL mund të procedohen për shqyrtim dhe për miratim në Kuvend.

b. U caktua Behar Selimi, kryesuesi i grupit të punës për PL për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:20

Kryetari i Komisionit

E përgatiti:

Arben Gashi

Stafi mbështetës i Komisionit

Aneks

Amendamentet në Projektkodin për marrëdhëniet e detyrimeve .

Amendamenti 1

Neni 6

Paragrafi 1, fjala “**dal**in” hiqet dhe zëvendësohet me fjalën “**rrjedh**in”.

Amendamenti 2

Neni 7

Titulli riformulohet si vijon: “**Parimi i ekuivalencës së preftimeve**”.

Paragrafi 1, fjala “**themel**imin” hiqet dhe zëvendësohet me fjalën “**krij**imin” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Paragrafi 2, në rreshtin e dytë, fjala “**qëll**im”, hiqet dhe zëvendësohet me fjalën “**par**im”.

Amendamenti 3

Neni 8

Në paragrafin 1, rreshti i parë riformulohet si vijon: “**Pjesëmarrësit në marrëdhënien e**” dhe teksti vazhdon si në projektligj. Kurse në paragrafin 2, në rreshtin e tretë, fjala “**detyr**imit”, zëvendësohet me fjalën “**detyr**imeve”.

Amendamenti 4

Neni 10

Në rreshtin e dytë, fjala “**konf**liktet”, hiqet dhe zëvendësohet me fjalën “**kont**estet” dhe në rreshtin e fundit fjala “**paq**ësore” hiqet dhe zëvendësohet me fjalët “**me paj**timin e **pjes**ëmarrësve”.

Amendamenti 5

Neni 12

Rreshti i parë riformulohet si vijon: “**Dispozitat e këtij Ligji në**” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 6

Neni 15

Titulli i nenit riformulohet si vijon: **“Lidhja e kontratës”**.

Amendamenti 7

Neni 16

Riformulohet si vijon: **“Kurë palët besojnë se janë pajtuar, kurse midis tyre ekziston mosmarrëveshja rreth elementeve thelbësore të kontratës, kontrata nuk do të konsiderohet e lidhur”**.

Amendamenti 8

Neni 17

Në rreshtin e parë fjalët **“në qoftë se dikush”** hiqen dhe zëvendësohen me fjalët **“Kushdo që”** dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 9

Neni 19.1

Në rreshtin e dytë hiqet fjala **“pëlqimi”** dhe zëvendësohet me fjalën **“aprovimi”** dhe në rreshtin e tretë hiqet fjala **“pëlqim”** dhe zëvendësohet me fjalën **“aprovim”**.

Amendamenti 10

Neni 22

Në rreshtin e tretë fjalët **“e cila ofertë”** hiqen, dhe në paragrafin 2, rreshti i 7-të, fjala **“sekondare”** hiqet dhe zëvendësohet me fjalën **“dytësore”** dhe në rreshtin e 10 hiqet fjala **“dëshmuar”** dhe zëvendësohet me fjalën **“krijuar”** dhe teksti vazhdon si në projektligj. Kurse në paragrafin 3, në rreshtin e 5-të, hiqet fjala **“del”** dhe zëvendësohet me fjalën **“rrjedh”**.

Amendamenti 11

Neni 24

Paragrafi 1, në rreshtin e gjashtë, hiqet fjala **“thirrje”** dhe zëvendësohet me fjalën **“ftesë”** dhe në paragrafin 2, në rreshtin e parë, hiqet fjala **“thirrjeve”** dhe zëvendësohet me fjalën **“ftesave”**.

Amendamenti 12

Neni 25.1

Rreshti i parë riformulohet si vijon: **“Ofertuesi është i lidhur me ofertën”** dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 13

Neni 26

Paragrafi 4 rreshti, i dytë dhe në paragrafin 5, rreshti i parë, hiqet fjala **“direkte”** dhe zëvendësohet me fjalën **“drejtpërdrejt”** dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 14

Neni 29

Paragrafi 2, në rreshtin e 7, hiqet fjala **“pajtim”** dhe zëvendësohet me fjalën **“përputhje”** dhe në paragrafin 3, në rreshtin e 3, hiqen fjalët **“e të mirave”** dhe zëvendësohen me fjalën **“mallrave”**, kurse në rreshtin e katërt, hiqet fjala **“furnizimit”** dhe zëvendësohet me fjalën **“dorëzimit”** dhe në rreshtin e gjashtë, hiqet fjala **“mosmarrëveshjeve”** dhe zëvendësohet me fjalën **“kontesteve”**.

Amendamenti 15

Neni 34

Paragrafi 1, hiqen fjalët **“bërje mosbërje”** dhe zëvendësohen me fjalët **“veprim mosveprim”**.

Amendamenti 16

Neni 35

Titulli **“Nuliteti i kontratës”** hiqet dhe zëvendësohet me titullin **“Kontrata nule”** dhe në rreshtin e tretë, pas fjalës **“është”**, shtohet fjala **“absolutisht”** dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 17

Neni 38

Paragrafi 2, në rreshtin e 3, hiqet fjala **“nule”** dhe zëvendësohet me fjalët **“absolutisht e pavlefshme”**

Amendamenti 18

Neni 39

Paragrafi 4, në rreshtin e dytë, pas fjalës **“dhe”** shtohet fjala **“absolutisht”** dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 19

Neni 43

Në titull hiqet fjala “**thirrja**” dhe zëvendësohet me fjalën “**ftesa**”.

Amendamenti 20

Neni 49

Paragrafi 1, rreshti i tretë, hiqet fjala “**cytë**” dhe zëvendësohet me fjalën “**shtyj**”. Kurse në paragrafin 2, në rreshtin e tretë hiqet fjala “**shkaktuar**” dhe zëvendësohet me fjalën “**pësuar**”

Amendamenti 21

Neni 51

Paragrafi 2, hiqet fjala “**ligjor**” dhe shtohen fjalët “**me ligj**” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 22

Neni 58

Në titull, pas fjalës “**kontrata**”, shtohet fjala “**e përmbushur**”

Amendamenti 23

Neni 68

Paragrafi 1, në rreshtin e 4, hiqet fjala “**dëshirës**” dhe zëvendësohet me fjalën “**vullnetit**” dhe teksti vazhdon si në projektligj. Kurse në paragrafin 2, në rreshtin 4, hiqet fjala “**dëshirës**” dhe zëvendësohet me fjalën “**zgjedhjes**”.

Amendamenti 24

Neni 70

Paragrafi 3, në rreshtin e parë dhe në paragrafin 4, në rreshtin 3, hiqet fjala “**legjitimuar**” dhe zëvendësohet me fjalën “**autorizuar**” dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 25

Neni 72

Paragrafi 1 riformulohet si vijon: “**Lidhja e kontratës dhe punët e tjera juridike mund të kryhen edhe me përfaqësues.**”

Paragrafi 2, rreshti i parë riformulohet si vijon: **“Autorizimi për përfaqësim bazohet në”** dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 26

Neni 75

Paragrafi 1, hiqet fjala **“kapërcen”** dhe zëvendësohet me fjalën **“tejkalon”**.

Amendamenti 27

Neni 77

Paragrafi 1, në rreshtin 2, hiqen fjalët **“veprim juridik”** dhe zëvendësohen me fjalët **“punë juridike”** dhe teksti vazhdon si në projektligj.

Amendamenti 28

Neni 100 fjalia e fundit **“(Koment: nga neni 163 e tutje përdoret termi e rrezueshme, ndërsa lart nenit 163 e anulueshme)”**, **hiqet.**

Amendamenti 29

Neni 136.1

Riformulohet si vijon:

“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij.”

Amendamenti 30

Neni 142.2

Riformulohet si vijon:

“I mituri prej moshës shtatëvjeçare, deri në moshën katërmëdhjetë vjeçare, nuk përgjigjet për dëmin e shkaktuar, përveç në qoftë se provohet se gjatë shkaktimit të dëmit ka qenë i aftë për të gjykuar.”

Amendamenti 31

Neni 162

Në fund të tekstit të kësaj dispozite hiqen fjalët **“e të tjera”**.

Amendamenti 32

Neni 173

Në titull hiqet fjala “**rëndomtë**” dhe zëvendësohet me fjalën “**real**”

Amendamenti 33

Nënkreu 7. (III), në titullin para nenit 177, hiqet fjala “**veçmas**” dhe zëvendësohet me fjalën “**rregullat**”.

Amendamenti 34

Libri 2, pjesa 1, titulli riformulohet si vijon: “**Kontrata për shitjen**”.

Amendamenti 35

Pas nenit 529, “**NËNKREU 6**” hiqet dhe zëvendësohet me “**NËNKREU 7**”.

Amendamenti 36

Pas nenit 530 fjalët “**PJESA 2**” hiqet dhe zëvendësohet me “**NËNKREU 8**”.

Amendamenti 37

Pas nenit 533, “**PJESA III**” hiqet dhe zëvendësohet me “**PJESA II**”, dhe titulli riformulohet si vijon: “**KONTRATA PËR KËMBIMIN**”.

Amendamenti 38

Pas nenit 535 “**PJESA IV**” hiqet dhe zëvendësohet me “**PJESA III**”.

Amendamenti 39

Pas nenit 548 “**PJESA V**” hiqet dhe zëvendësohet me “**PJESA IV**” dhe pas fjalës “**KONTRATA**” fjala “**MBI**” hiqet dhe zëvendësohet me fjalën “**PËR**”.

Amendamenti 40

Pas nenit 559 “**PJESA VI**” hiqet dhe zëvendësohet me “**PJESA V**”.

Amendamenti 41

Pas nenit 566 “**PJESA VII**” hiqet dhe zëvendësohet me “**PJESA VI**”.

Amendamenti 42

Pas nenit 576 “**PJESA VIII**” hiqet dhe zëvendësohet me “**PJESA VII**”.

Amendamenti 43

Pas neni 584, “**PJESA IX**” hiqet dhe zëvendësohet me “**PJESA VIII**”, dhe titulli riformulohet si vijon: “**KONTRATA PËR QIRANË**”.

Amendamenti 44

Pas nenit 616 “**PJESA X**” hiqet dhe zëvendësohet me “**PJESA IX**”.

Amendamenti 45

Pas nenit 646 “**PJESA XI**” hiqet dhe zëvendësohet me “**PJESA X**”.

Amendamenti 46

Pas nenit 663 “**PJESA XII**” hiqet dhe zëvendësohet me “**PJESA XI**”.

Amendamenti 47

Pas nenit 701 “**KREU XIII**” hiqet dhe zëvendësohet me “**PJESA XII**”.

Amendamenti 48

Pas nenit 727 “**PJESA XIV**” hiqet dhe zëvendësohet me “**PJESA XIII**” dhe titulli riformulohet si vijon: “**KONTRATA PËR DEPOZITËN**”.

Amendamenti 49

Pas nenit 745 “**PJESA XV**” hiqet dhe zëvendësohet me “**PJESA XIV**” dhe titulli riformulohet si vijon: “**KONTRATA PËR MAGAZINIMIN**”.

Amendamenti 50

Pas nenit 764 “**PJESA XVI**” hiqet dhe zëvendësohet me “**PJESA XV**” dhe titulli riformulohet si vijon: “**KONTRATA PËR URDHËRIN**”.

Amendamenti 51

Pas nenit 786 “**PJESA XVII**” hiqet dhe zëvendësohet me “**PJESA XVI**” dhe titulli riformulohet si vijon: “**KONTRATA PËR KOMISIONIN**”.

Amendamenti 52

Pas nenit 805 **“PJESA XVIII”** hiqet dhe zëvendësohet me **“PJESA XVII”** dhe titulli riformulohet si vijon: **“KONTRATA PËR PËRFAQËSIMIN TREGTAR”**.

Amendamenti 53

Pas nenit 835 **“PJESA XIX”** hiqet dhe zëvendësohet me **“PJESA XVIII”**.

Amendamenti 54

Pas nenit 849 **“PJESA XX”** hiqet dhe zëvendësohet me **“PJESA XIX”** dhe titulli riformulohet si vijon: **“KONTRATA PËR SHPEDITIMIN (DËRGIMI)”**.

Amendamenti 55

Pas nenit 869 **“PJESA XXI”** hiqet dhe zëvendësohet me **“PJESA XX”**.

Amendamenti 56

Pas nenit 881 **“PJESA XXII”** hiqet dhe zëvendësohet me **“PJESA XXI”**.

Amendamenti 57

Pas nenit 902 **“PJESA XXIII”** hiqet dhe zëvendësohet me **“PJESA XXII”**.

Amendamenti 58

Pas nenit 907 **“PJESA XXIV”** hiqet dhe zëvendësohet me **“PJESA XXIII”**.

Amendamenti 59

Pas nenit 919 **“PJESA XXV”** hiqet dhe zëvendësohet me **“PJESA XXIV”** dhe titulli riformulohet si vijon: **“KONTRATA PËR SIGURIMIN”**.

Amendamenti 60

Pas nenit 988 **“PJESA XXVI”** hiqet dhe zëvendësohet me **“PJESA XXV”**.

Amendamenti 61

Pas nenit 1001 **“PJESA XXVII”** hiqet dhe zëvendësohet me **“PJESA XXVI”**.

Amendamenti 62

Pas nenit 1010 **“PJESA XXVIII”** hiqet dhe zëvendësohet me **“PJESA XXVII”** dhe titulli riformulohet si vijon: **“KONTRATA PËR DORËZANINË”**.

Amendamenti 63

Pas nenit 1033 “**PJESA XXIX**” hiqet dhe zëvendësohet me “**PJESA XXVIII**” dhe titulli riformulohet si vijon: “**KONTRATA PËR DËRGIMIN (ASIGNACIONI)**”.

Amendamenti 64

Pas nenit 1048 “**PJESA XXX**” hiqet dhe zëvendësohet me “**PJESA XXIX**”

Amendamenti 65

Pas nenit 1058 “**PJESA XXXI**” hiqet dhe zëvendësohet me “**PJESA XXX**”

Amendamenti 66

Ne nenin 1060 shtohet paragrafi i ri si vijon:

“2. Në kuptim të këtij Ligji, e në pajtim me Nenin 145 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ligj i aplikueshëm për kontratat për shitjen ndërkombëtare të mallrave është Konventa e Kombeve të Bashkuara për kontratat për shitjen ndërkombëtare të mallrave”, ndërsa paragrafi 2 bëhet 3 dhe renditja e paragrafëve në vazhdim bëhet sipas numrave me radhë.